

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 6, datë 17.9.2025

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË PËRDORIMIT TË PASURIVE KULTURORE NË ADMINISTRIM TË MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR TRASHËGIMINË KULTURORE

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 178, pika 4, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, i ndryshuar, dhe kreut V, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 857, datë 24.12.2019, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të konkurrimit, formën dhe kohëzgjatjen e kontratës dhe metodologjinë e caktimit të tarifave për dhënien në përdorim të pasurive kulturore publike”,

UDHËZOJMË:

1. Tarifat për përdorimin e drejtpërdrejtë të pasurive kulturore të paluajtshme përcaktohen sipas shtojcës 1 që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.
2. Tarifat për dhënien në përdorim me qëllim rijetëzimi të pasurive kulturore të paluajtshme për aktivitete kulturore caktohen sipas shtojcës 2 që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.
3. Tarifat për përdorimin e drejtpërdrejtë të pasurive kulturore të luajtshme dhe riprodhimit caktohen sipas shtojcës 3 që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.
4. Ngarkohet ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore për zbatimin e këtij udhëzimi.
5. Çdo akt tjetër nënligjor që përcakton tarifa të përdorimit të pasurive kulturore në administrim të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, shfuqizohet.
6. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCEVE

Petrit Malaj

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

Blendi Gonxhja

SHTOJCË 1

TARIFAT E DHËNIES NË PËRDORIM TË DREJTPËRDREJTË TË PASURIVE KULTURORE TË PALUAJTSHME PËR AKTIVITETE KULTURORE

Lloji i aktivitetit	Tarifa
Hapësirë brenda Pasurisë kulturore Objektet: Kalaja e Gjirokastrës Kalaja e Porto Palermos Kalaja e Kaninës Kalaja e Himarës Kalaja e Lezhës Kalaja e Shkodrës Kalaja e Lëkursit Kalaja e Bashtovës Kalaja e Prezës Kalaja e Petrelës Parku Arkeologjik Apoloni dhe Bylis	

Parku Arkeologjik Amantia Parku Arkeologjik Orikum Parku Arkeologjik Finiq	
Aktivitete jofitimprurëse: - Vizitë e jashtëzakonshme dhe ekskluzive - Event privat (prezantim) editorial, konferencë, konventë) - Shfaqje/koncerte që nuk ofrojnë shitjen e një biletë	122,000 lekë/ditë ose 10,014 lekë/orë
Aktivitete me qëllim fitimin ose komerciale: - Prezantim editorial/konferencë ose konventë; - Ekspozitat e përkohshme që nuk janë të organizuara nga institucioni pritës; - Shfaqje/koncerte që ato ofrojnë shitjen e një biletë; - Shërbime fotografike;	171,633 lekë/ditë ose 14,030 lekë/orë
Aktivitete me qëllim dokumentimin, riprodhimin: - Fushatat reklamuese; - Filmime për seriale televizive dhe filma artistikë; - Formatet televizive dhe videot muzikore; - Shfaqje televizive; - Xhirime video për qëllime private; - Dokumentarë, filma të shkurtër.	67,300 lekë/ditë ose 5,009 lekë/orë
Hapësirë brenda pasurisë kulturore objektet: Muzeu Historik Kombëtar Muzeu i Pavarësisë Vlorë Muzeu i Fotografisë Marubi Muzeu Kombëtar Shtëpia me Gjethe	
Aktivitete jofitimprurëse: - Vizitë e jashtëzakonshme dhe ekskluzive - Event privat (prezantim) editorial, konferencë, konventë) - Shfaqje/koncerte që nuk ofrojnë shitjen e një biletë	104,000 lekë/ditë ose 10,008 lekë/orë
Aktivitete me qëllim fitimin ose komerciale: - Prezantim editorial/konferencë ose konventë; - Ekspozitat e përkohshme që nuk janë të organizuara nga institucioni pritës; - Shfaqje/koncerte që ato ofrojnë shitjen e një biletë; - Shërbime fotografike;	132,933 lekë/ditë ose 14,017 lekë/orë
Aktivitete me qëllim dokumentimin, riprodhimin: - Fushatat reklamuese; - Filmime për seriale televizive dhe filma artistikë; - Formatet televizive dhe videot muzikore; - Shfaqje televizive; - Xhirime video për qëllime private; - Dokumentarë, filma të shkurtër.	55,600 lekë/ditë ose 5,005 lekë/orë
Hapësirë brenda pasurisë kulturore objektet: Muzeu Etnografik Krujë Muzeu Etnografik Berat Muzeu Ikonografik Berat Muzeu Arkeologjik Korçë Muzeu i Arsimit Korçë	
Aktivitete jofitimprurëse: - Vizitë e jashtëzakonshme dhe ekskluzive - Event privat (prezantim) editorial, konferencë, konventë) - Shfaqje/Koncerte që nuk ofrojnë shitjen e një biletë	104,000 lekë/ditë ose 10,008 lekë/orë
Aktivitete me qëllim fitimin ose komerciale: - Prezantim editorial/ konferencë ose konventë; - Ekspozitat e përkohshme që nuk janë të organizuara nga institucioni pritës; - Shfaqje/Koncerte që ato ofrojnë shitjen e një biletë;	132,933 lekë/ditë ose 14,017 lekë/orë

- Shërbime fotografike;	
Aktivitete me qëllim dokumentimin, riprodhimin:	
- Fushatat reklamuese;	
- Filmime për seriale televizive dhe filma artistikë;	
- Formatet televizive dhe videot muzikore;	
- Shfaqje televizive;	
- Xhirime video për qëllime private;	
- Dokumentarë, filma të shkurtër.	
	55,600 lekë/ditë ose 5,005 lekë/ora

SHTOJCA 2
TARIFAT E DHËNIES NË PËRDORIM PËR QËLLIM RIJETËZIMI TË PASURIVE
KULTURORE TË PALUAJTSHME

	Pasuria kulturore	Tarifa (lekë/muaj)
1	Kalaja e Gjirokastrës	348,500 lekë/muaj
2	Kalaja e Porto Palermos	235,500 lekë/muaj
3	Kalaja e Kaninës	156,000 lekë/muaj
4	Kalaja e Himarës	156,000 lekë/muaj
5	Kalaja e Lezhës	176,000 lekë/muaj
6	Kalaja e Shkodrës	340,850 lekë/muaj
7	Kalaja e Lëkursit	390,000 lekë/muaj
8	Kalaja e Bashtovës	175,000 lekë/muaj
9	Kalaja e Prezës	216,200 lekë/muaj
10	Kalaja e Petrelës	236,300 lekë/muaj
11	Muzeu Historik Kombëtar	113,000 lekë/muaj
12	Muzeu Kombëtar i Pavarësisë Vlorë	124,000 lekë/muaj
13	Muzeu Kombëtar Fotografisë Marubi	124,000 lekë/muaj
14	Muzeu Kombëtar Shtëpia me Gjethe	124,000 lekë/muaj
15	Muzeu Gjergj Kastrioti Krujë	300,000 lekë/muaj
16	Muzeu Etnografik Krujë	218,400 lekë/muaj
17	Muzeu Etnografik Berat	113,775 lekë/muaj
18	Muzeu Ikonografik Berat	113,775 lekë/muaj
19	Muzeu Arkeologjik Korçë	176,000 lekë/muaj
20	Muzeu i Arsimit Korçë	113,775 lekë/muaj
21	Parku Arkeologjik Apoloni dhe Bylis	156,000 lekë/muaj
22	Parku Arkeologjik Amantia	103,000 lekë/muaj
23	Parku Arkeologjik Orikum	103,000 lekë/muaj
24	Parku Arkeologjik Finiq	103,000 lekë/muaj

SHTOJCË 3
TARIFAT E DHËNIES NË PËRDORIM TË DREJTPËRDREJTË TË PASURIVE
KULTURORE TË LUAJTSHME DHE E RIPRODHIMIT

Kategoria	Tarifa
Shërbime që kërkojnë printim	
- Botime dhe revista shkencore në sektor në kanale komerciale <i>online</i> /në letër;	
- Publikime <i>online</i> ;	
- Broshura, postera, fletushka, promovim në media të tjera gjatë ekspozitave ose shfaqjeve;	
- Publikime të kopertinës;	
- Publikime të tjera përveç atyre shkencore;	
Shërbime që kërkojnë riprodhim	
	2,511 lekë/copë
	3,516 lekë/copë